

## **Neni 19**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996)*

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003)*

- 1) Punëdhënësi punëson në mënyrë të drejtpërdrejtë punëmarrësin.
- 2) Punëdhënësi, për të punësuar punëmarrësin, mund të përdorë shërbimet e zyrave shtetërore të punësimit ose të agjencive private të punësimit.
- 3) Veprimtaria private e ndërmjetësimit në punë për qëllime fitimi i nënshtrohet të njëjtave rregulla që përcakton Këshilli i Ministrave për ushtrimin e veprimtarisë shtetërore të ndërmjetësimit në punë.

## **AFTËSIA PËR TË KONTRAKTUAR**

### **Neni 20**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996)*

- 1) Kanë të drejtë të lidhin kontratë pune:
  - a. Personat që gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar sipas dispozitave të Kodit Civil;
  - b. personat me zotësi të kufizuar, por të autorizuar shprehimisht ose në heshtje për të kryer punë nga përfaqësuesi i tyre ligjor.
- 2) Personat e përmendur në shkronjën "b" të këtij neni ushtrojnë të drejtat dhe përbushin detyrimet që rrjedhin nga kontrata si gjithë punëmarrësit e tjerë dhe kanë të drejtë ta zgjidhin këtë kontratë.

## **FORMA E KONTRATËS SË PUNËS**

### **Neni 21**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.07.2003)*

- 1) Kontrata e punës mund të lidhet dhe ndryshohet me gojë ose me shkrim. Ajo mund të ndryshohet vetëm në marrëveshje midis palëve. Çdo ndryshim i kontratës së shkruar, në dëm të punëmarrësit, duhet të përfundohet me shkrim.
- 2) Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëdhënësi pranon kryerjen e punës për një kohë të caktuar ose të pacaktuar, në kuadrin e organizimit dhe nën urdhrat e tij dhe që në bazë të këtyre rrethanave kryhet vetëm kundrejt pagesës.
- 3) Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos:
  - a. identitetin e palëve;
  - b. vendin e punës;
  - c. përshkrimin e përgjithshëm të punës;
  - d. datën e fillimit të punës;
  - e. kohëzgjatjen kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar;
  - f. kohëzgjatjen e pushimeve të paguara;
  - g. afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës;
  - h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj;
  - i. kohën normale javore të punës;
  - j. kontrata e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive në fuqi.
- 4) Kur kontrata e punës lidhet me gojë, punëdhënësi është i detyruar që, brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, të hartojë me shkrim dokumentin përkatës, të nënshkruar prej tij dhe punëmarrësit, ku të përfshihen sidomos

elementet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Moshartimi i këtij dokumenti me shkrim nuk cenon vlefshmërinë e kontratës, por sjell vetëm përgjegjësinë e punëdhënësit, sipas nenit 202 pika 2 të këtij Kodi.

5) Informacioni lidhur me elementet e parashikuara në paragrafin e tretë shkronja “f”, “g”, “h” dhe “i”, në rast nevoje, jepet me anë referencash ndaj dispozitave të Kodit, të vendimeve të Këshillit të Ministrave ose të një kontrate kolektive.